Afati për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve

Afati për paraqitjen e komenteve dhe rekomandimeve përcaktohet në njoftimin për konsultim publik dhe, në përputhje me legjislacionin në fuqi, nuk mund të jetë më i shkurtër se 20 ditë kalendarike nga data e publikimit të draftaktit apo dokumentit për konsultim publik, përveç rasteve të parashikuara ndryshe me ligj, bazuar në nenin 17 të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Komentet e paraqitura brenda afatit ligjor administrohen dhe bëhen pjesë e procesit të shqyrtimit institucional nga Bashkia Pustec.